ADEM ZAPLLUZHA

KËSAJ NUK I THEM DOT LIRI

Redaktor:
Kopi Kyçyku

Recensent:
Vasil Tabaku

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Afrim Shatku

ADEM ZAPLLUZHA

KËSAJ NUK I THEM DOT LIRI

"TREND"
2016

Poeti që nuk e përsëriti asnjëherë vetveten

Prof. Kopi kyçyku

Duke lëçitur me vëmendjen e merituar këtë vëllim të Adem Zaplluzhës, të përforcohet bindja se ky poet tejet prodhimtar është i aftë të mos e përsëritë vetveten as atëherë kur i rikthehet së njëjtës temë. Kjo e fundit nuk është vetëm një. Fjala është për një larmi subjektesh që nisin me ndjenjat më intime të njeriut të dashuruar e vazhdojnë me shpërthimet e vrullshme atmëmëdhetare, për të mos u shterur kurrë trajtesat e aspekteve të ndryshme të jetës e të veprimtarisë shoqërore. Këndvështrimet e Ademit janë sa ylberore, aq edhe të befta. Në shumicën e rasteve mbyllja nuk hamendësohet as nga titulli e as nga zbërthimi i përmbajtjes në vargje. Më tej: befasia nuk bëhet qëllim në vetvete, por, krahas thyerjes së monotonisë që haset rrallë në mjaft autorë të tjerë, gjendemi përballë shpalosjes së një realiteti që, shumë-shumë e kemi ëndërruar, por nuk e kemi prekur as me shqisa e as me përfytyrimet tona. Gjithaq me rëndësi është të vëmë në dukje se vargu i Ademit rrjedh si uji i burimit, figuracioni është me sens mase, larg sensacioneve apo efekteve të bujshëm e të sipërfaqshëm. Elementët stilistikë dhe artistikë janë në varësi të idesë që kumtojnë, nuk i rrinë

përsipër kësaj të fundit, por as i kundërvihen. Ata mbeten brenda rolit që kanë, pra si mjete për të shpalosur sa më këndshëm mendimet. Tipar themelor i poezisë së Adem Zaplluzhës, do të thosha gjenetik, është dashuria për të parët e vet, për trojet shqiptare, brenda ose përkohësisht jashtë kufijve shtetërorë të dy shteteve kombëtare dhe optimizmi për një të ardhme të ndritur të shqiptarisë.

Bukuresht, 29 shtator 2015

NGA VASIL TABAKU

ADEM ZAPLLUZHA PËRBALLË NJË REALITETI TE RI POETIK TË MREKULLUESHËM

Të shkruash duke vënë si një peng të vërtetë shpirtin tënd, dhimbjen tënde, zemrën dhe dashurinë, të sotmen dhe të nesërmen, këtë bënë poeti I mrekullueshëm dhe plot risi poetike ADEM ZAPLLUZHA edhe në librin e tij më të fundit poetik **"KËSAJ NUK I THEM DOT LIRI".**Në gjithë universin krijues të këtij autori mjaft prodhues dhe të veçantë plotë risi poetike dhe padyshim mjaft cilësor në krijimtari, të bie në sy lajtmotivi universal i këtij krijuesi, shpirti i lirë, gjëmues dhe shpërthyes, që nuk pranon asnjë lloj kushti aq më pak pranga. Shpirti poetik i Zaplluzhës do të thosha se është një vullkan krijues në erupsion të plot dhe vital aq sa shpesh të lë pa fjalë. E them këtë jo vetëm për vitalitetin krijues të këtij autori brilant, por edhe për vokacionin e gjerë e të veçantë dinamik dhe shpërthyes, sa origjinal aq dhe tradicional, sa meditues aq dhe filozofik. Përsiatjet e poetit zgjojnë mori të tëra mendimesh tek lexuesi dhe e robërojnë atë deri në vargun e fundit të poezisë së librit. Ky autor i veçantë në Letrat Shqipe, krijon kështu një botë të vetën poetike, një domen të jashtëzakonshëm plot brilante poetike,

më një anatomi magjike të Kosovës dhe të Shqipërisë , ku unë do të doja më fjalën Shqipëri të përfshija Kosovën Maqedoninë shqiptare, Malin e Zi shqiptar dhe gjithë trevat ku jetojnë shqiptarët kudo në diasporë. Kjo gjë I jep ADEM ZAPLLUZHËS "pasaportën" për të hyrë nëpër zemrat e mëdha të të gjithë shqiptarëve kudo qe janë dhe të shndërrohet në BARDIN e madh të tyre më fjalën, mendimin dhe filozofinë e vetë poetike… ZAPLLUZHA është një krijues me dimensione por dhe me vlera që ngërthejnë një artist me një botë të madhe shpirtërore , me një art të konsoliduar, mjeshtëror dhe tepër shprehës… ADEM ZAPLLUZHA, KY BARD I MADH I LIGJËRIMIT POETIK Unë do ta quaja pa asnjë hezitim BARD I MADH ,krijuesin ADEM ZAPLLUZHA, sepse këtë të drejtë unikale ta jep vet poezia e poetit ZAPLLUZHA me forcën e saj, me vlerat e saj, me universialitetin e saj dhe gjithë përfshirjen kombëtare. Poeti e gjen ashtin e ligjërimit të vet pikërisht aty ku ai ka lindur në opusin e madh të melosit të KOSOVËS dhe gjithë SHQIPËRISË duke i dhënë jetë vargut poetik me një forcë të veçantë dhe origjinale sepse poeti di të depërtoj nëpër pejzat e holla delikate të shpirtit të njerëzve dhe tu jap atyre vlerat e një poezie të bukur, magjike dhe depërtuese gjer në zemër…Ai gërsheton në mënyrë perfekt metoniminë dhe vlerat njerëzore, duke i gërshetuar përmes një figuracioni mjaft të gjetur dhe artistik…

"**Zërat e fjetur të yjeve të përhumbur**
Zgjohen nga legjendat
Jashtë hapësirës së mendjes
Si kuajt e paçjerrë vrapojnë meteorët"

Shprehet poeti tek poezia “TI NË DAÇ MË PRIT TE PORTAT E HAPURA” Natyrisht përmes melosit, poeti ZAPLLUZHA, di të ndërthurë me mjaft mjeshtëri, të bukurën dhe befasuesen, magjiken dhe artistiken. Autori është kërkues dhe këmbëngulës, është i detajuar në çdo varg dhe ndërton një poezi e cila reflekton mjeshtëri, art dhe risi poetike. Këto i materializon me shume art në çdo poezi të librit, edhe pse ky libër është libri i 138 i këtij autori, një krijimtari vërtetë e jashtëzakonshme, e admirueshme, e respektueshme dhe vitale nga një krijues mjaft potent, prodhues dhe origjinal dhe që çuditërisht dhe mrekullisht nuk ka asnjë grimë përsëritje të vetvetes, qoftë edhe në një varg të vetëm jo më një poezi apo libër. Të lë pafjalë kjo veçori dalluese dhe e mahnitshme e ADEM ZAPLLUZHËS krijues me merita të rralla dhe të shkëlqyera, të cilat I kanë hapur këtij DEMIURGU të MADH portat e një PANTEONI NDERI në LETRAT SHQIPE. Autori e mere forcën, vitalitetin dhe bekimin pikërisht tek ajo çka thamë më sipër, te melosi i madh i popullit, ku në një mënyrë mjaft fine dhe elegante shpërfaqet ligjërimi i tij i mrekullueshëm dhe befasues, me një figuracion të rrallë mjeshtëror dhe të goditur, gjithmonë në vendin e duhur.

“Për befasinë time
Mbrëmë më pushuan dhembjet
Ndoshta ishe ti që erdhe kaq vonë
Të m’i shërosh plagët që kullojnë”

Nënvizon poeti te poezia **“Një flutur e kaltër**”, A nuk të kujton kjo poezi e bukur eksklamacionin brilant tek eposi për Gjergj Elez Alin me shtatë plagët që ja mëkon zana, kush është kjo femër që vjen dhe i heq dhimbjet protagonistit të poezisë së ZAPLLUZHËS, padyshim që nuk është plagjiaturë, por një pikënisje ku shkrihet melosi i legjendës me amën krijuese të këtij poeti të veçantë. Pra nëse do të bënim një përqasje për origjinalitetin poetik të ZAPLLUZHËS, unë me plotë gojën do të thosha se ky autor është një BARD i MADH që di të ndërtoj VARGJE TË RRALLË, PLOT BUKURI DHE SHPIRT TË MADH DHE SHPËRTHYES. Pa dyshim poeti është i ndërgjegjshëm se ka ndërtuar një godinë poetike të veçantë, të tijën, origjinale, shprehëse dhe mjaft komunikative me lexuesin. Një ligjërim sa modest aq dhe modern, sa domethënës aq dhe shprehës e i fuqishëm. Sepse sikundër thotë poeti ,

“Isha Zot i zogjve në fluturim
Isha zëri dhe shpirti i erës “

Tepër domethënëse dhe shprehëse, ky është poeti që jeton brenda shpirtit të njeriut të dhimbjes, në universin e fluturimit dhe zërin e erës...Mjaft bukur dhe thjesht, mjaft çiltër dhe bukur, kështu na befason poeti brilant ZAPLLUZHA me vargun e vet të skalitur dhe shndritës, si një DEMIURG, sepse brenda tij është ngjizur edhe dhimbja edhe lumturia, edhe trishtimi edhe shpresa, edhe zëri edhe drita, edhe heshtja edhe shpërthimi dhe stuhia. Gjithçka tek ky autor është poezi gjer në rrënjë,

gjer në palcë gjer në dhimbje,poezi që të rrëmben, të pushton dhe të bënë të jetosh përmes ëndrrës dhe shpresës, përmes dritës dhe dashurisë...Mjeshtëria artistike e autorit ka gjetur vërtetë shtigje të reja shprehëse dhe kumtimi, sepse në çdo varg vjen një mesazh, vjen vet zëri i brendshëm dhe i padukshëm i poetit, vjen çiltërsia dhe sinqeriteti i tij i jashtëzakonshëm...

VLERAT ARTISTIKE DHE KUJDESI ESTETIK I ADEM ZAPLLUZHËS

Gjithë prozodia poetike e ZAPLLUZHES në librin e tij më të fundit, manifeston një përkushtim të veçantë dhe të rrallë të autorit me paraqitjen estetike dhe vlerat në mënyrë të drejtpërdrejtë. Autori në të vërtetë duhet thënë se është një krijues i lindur autentik dhe me një forcë shprehëse mjaft të rrallë, por në të njëjtën kohë në gjithë opusin e vet të madh krijues me një mori librash, ai ruan vlerat dhe mbi të gjitha bënë një kujdes të habitshëm estetik, me mjaft shije, elegancë dhe finesë në shprehjen e tij poetike që në të shumtën e rasteve është e mrekullueshme dhe bindëse,pse jo dhe e pabesueshme...por që në fakt është e vërtetë, tepër e vërtetë... Unë shpesh gjej në poezitë e ZAPLLUZHËS një magji të veçantë por mjaft fine dhe dinjitoze. Dhe natyrisht e gjithë kjo vjen padyshim nga maturia e këtij krijuesi, ruajtjes së masës dhe njohjes së thellë të misterit të vargut poetik, ndryshe nuk mund të ndodh e gjithë kjo përkujdesje që të sugjestionon dhe të mbush

me konsideratë për autorin ZAPLLUZHA. Ai ka krijuar kështu një shkollë të vetën poetike , një mënyrë mjaft origjinale dhe shprehëse, plot vlera të veçanta që e dallojnë poezinë e tij mes qindra krijuesve bashkëkohorë qoftë në Kosovë apo dhe në Shqipëri dhe më gjerë. Autori, ka si orientim psikosocial, urtësinë, filozofinë e thellë shprehëse dhe padyshim një mesazh të shprehur mjaft qartë e në mënyrë tepër domethënëse. Një krijues i këtyre përmasave me të drejtë do ta cilësoja unikal dhe të suksesshëm. Ai ndërthur në mënyrë magjike mendimin, filozofinë dhe të ëndërrtën, atë që shpesh mbetet eterike, e pakapshme por që poeti e shndërron në të kapshme dhe të afërt. Intime dhe njerëzore.

"**Çfarë të bëj me këtë tatuazh të dhembjes**
Të gjitha udhët
Si plagët e erës më mbetën peng
Të kujtohet:

ishte dimër kur vdiq pema S'patëm kohë As t'i varrosnim kujtimet" Në mënyrën sesi vijon procedimi poetik, të lihet përshtypja sikur ti, pra lexuesi, je aty i pranishëm, brenda vargut poetik, brenda mendimit të autorit dhe përmasave të fjalës së tij, je "uni" artistik, je vetvetja e përfshirë në këtë magji krijuese që mbanë firmën e ADEM ZAPLLUZHËS, dhe fiton një vetëbesim dhe bëhesh bashkautor dhe bashkë lexues i vargjeve të tij...Në shumicën e vargjeve dominon metafora, por nuk është e rrallë edhe metonimia, aliteracioni dhe zëri i

brendshëm e i fshehtë i autorit. Këto vlera artistike, krijojnë një unitet krijues plot domethënie, me shumë lëndë poetike dhe ngjyrim të lart artistik .Kjo padyshim është cilësi e mjeshtërve dhe e gjithë atyre poetëve që dinë të ndërtojnë vargje me domethënie dhe ngarkesë artistike, poezi që mbajnë brenda bërthamës së tyre një unitet figurshmërie të përsosur dhe më një funksion të lart estetik. Autori, shpresoj se e ka njohur mjaft mirë edhe prozodinë popullore, sepse në vargjet e tij ka një harmonizim mahnitës të kësaj prozodie me ligjërimin e tij të mrekullueshëm, kumbues dhe me nota të thella atdhetarie, ku një shpirt i madh poetik ndërton një univers të vërtetë domethënëse dhe me mjaft kuptim.

“Nën këtë plis
Ndjehem si lis
Dardan me gjak të kulluar
Të më kenë lakmi diell e hënë
Ashtu siç më patën zili perënditë paganë
Nën këtë plis Të bardhë si dëbora e Sharrit
Ndjehem si lis
Le të më ketë zili edhe
Hyji i cili për kombin tim e pat qëndisur”

Autori ZAPLLUZHA, është padyshim dhe një atdhetar i rrallë, plot zjarr dhe dashuri për vendin, lirinë dhe kombin, sepse në gjithë poezinë e tij merr frymë liria dhe kombi, atdheu dhe krenaria kombëtare. Në shumë prej poezive të tij gjallon mjaft fuqishëm shpresa dhe liria, ndërsa thellë ,thellë vargjeve shpërthen dashuria

për KOSOVËN, këtë martirë të Lirisë në kohët moderne. Poeti është dhe një luftëtar i së vërtetës, një shpërthim i lirisë dhe vlerave të saj. Në gjithë opusin poetik të autorit këto mesazhe mbeten kryefjala e ti dhe lajtmotivi që e bënë të jetoj dhe të ligjëroj mjaft fuqishëm, plot pasion dhe art, plot ëndrra dhe shpresa...Sepse poeti e di mirë këtë sekret të rritjes dhe jetës, të shpresës dhe ditës, të dashurisë dhe së madhërishmes, ku gjithmonë jeta triumfon mes shumë dhimbjesh dhe dëshirash të fuqishme.

“Përditë vdesim nga pak
Vdesim si elefanti
Nga fytyra e drurit metaforik
Ngjizim mirazhe
Dhe më pas udhëtojmë drejt një drite”

E pra, kjo është dhe deviza e ADEM ZAPLLUZHËS, një devizë qe kurrë nuk do ta lërë në mes të rrugës, nuk do ta tradhtoj kurrë dhe nuk do ta zhgënjej. Autori na vjen mes nesh me një libër të realizuar, plot art dhe forcë tronditëse, ku zgjohen ëndrrat dhe marrin krahë shpresat, ku realiteti bëhet edhe më i kuptueshëm, më i dashur, më domethënës dhe më njerëzor. ADEM ZAPLLUZHA shfaqet kështu para lexuesit si një autor me mjaft pretendime dhe vlera të veçanta, origjinal, magjik, real dhe sugjestionues. Ai ka ndërtuar një realitet poetik mjaft të magjishëm, të suksesshëm dhe shprehës, por mbi të gjitha mjaft të ngrohtë dhe njerëzor. Autori na zgjon aq shumë mendime dhe shpresa, aq shumë

dashuri për njeri - tjetrin dhe aq shumë dëshirë për ta jetuar jetën me të gjitha përmasat e saj të larmishme, me dashurinë, dhimbjen, triumfin dhe trishtimin, me shpresën dhe ëndrrën,Unë mendoj se autorë të tillë vijnë rrallë mes nesh dhe padyshim që meritojnë gjithë vëmendjen dhe dashamirësinë tonë, përkrahjen dhe vlerësimin tonë të merituar.

Vasil Tabaku - Poet

Çfarë të bëj me duart e erës

Cikli i parë

KY SHI I ANKTHSHËM

Drurët e fshatit tim
Me nostalgji përtypin heshtjen
Agimet shigjetarë shikojnë hapësirën,
Në syrin e vëngër të ditës
Tretet kripa e djersitur e ullukëve të vjetër

Ky shi i ankthshëm që po bie sot
Orë e çast troket në xhamet e kujtesës
Jashtë në oborr këndojnë degët
Një serenatë të vjetër dardane
Ankthi zgjohet në shpirtin e gjetheve

Ky zë që fle tek unë me shekuj
Mbase është zëri i kitarës
Era këndon një melodi të lashtë
Nga buzët e zhuritura të pemëve
Si dhembja pikon nostalgjia

Nën pemët e përziera
Me vite s'pushon kori i këmijve
Ethet e drurëve kanë hyrë në arenë
Dhe si luanët e plagosur
Hungërojnë pranë shkallëve të rrënuara

MOS MA PREKNI KUJTESËN

O dhembja ime
Sapo të pashë lakuriqe
Në zërin e kujt u fundos dita
Kur iu thyen sinorët e heshtjeve?

Dua të rri sonte nën heshtjen e kujtesës
Të qëndroj deri në agim
Me ankthin tim
Kështu luleve ua shtoj guximin

Mos ma ngacmoni të kaluarën
Më lini të përsiat në heshtje
Kjo flakë që ndizet tek unë
Vetëm dhembja mund ta shkyçë dhembjen

Si të kuvendoj në këto çaste
Me flokët e shprishura të shpirtit
Kur era dremit si e dehur
Në kafenenë e kujtimeve të etjes

E KUJT ËSHTË KJO MELANKOLI?

Pamja ime harkore
Humbi në errësirën e tunxhtë
E kujt është kjo melankoli
Që më zgjon kaq herët?

Si ta dëgjoj këtë zhurmë
Kur heshtja tragjike mbytet brenda meje
Një dru i lagjes ka rënë në gjunjë
Dhe iu lutet të panjohurve paganë

Kot i dëgjoj zërat e drurëve
Kur zëri im i plagosur zhytet në qenien time
Si gjarpri i zi
Një gjeth i fishkur shpohet në vrimë

I humba të gjitha udhët
Në sytë e molisur të natës si kripa
Tretet largësia
Çfarë të bëj sonte me plagën time

TI NË DAÇ MË PRIT TE PORTAT E HAPURA

Zërat e fjetur të yjeve të përhumbur
Zgjohen nga legjendat
Jashtë hapësirës së mendjes
Si kuajt e paçjerrë vrapojnë meteorët

Ky shi sonte që nuk rresht
Me rrebesh po bie mbi flokët e stinës
Te portat e lashtësisë
Po trokasin korbat e kujtesës

Sonte nuk më zë gjumi
Por ti kot trokite në dritare
Unë mungoja në mungesën time
Isha jashtë hapësirës së mendjes

Ti në daç
Më prit te portat e hapura
Unë një ditë do t'i mbyll të gjitha dritaret
S'do të kem më shpresë për asnjë fluturim

ÇFARË TË BËJ ME DUART E ERËS?

Midis nesh një heshtje e gurëzuar
Loti i pikëllimit
I lan sytë
Me dhembjen e plagosur të ditës

Ti nuk ishe askund
Mungoje edhe në vetvete
Çfarë të bëj me duart e erës
Kur thyhen degët e kujtimeve

Ti nuk më besove asnjëherë
Era e përhumbur i grimcon thonjtë
Përtej pasqyrës së kujtesës
Nga një dhembje e përfytyruar dëgjohet gjëma

NË KËTO ÇASTE TË ANKTHSHME

Për një vdekje të bardhë
Duhet të kesh fuqi për të lindur
Këtu përherë në korin e etjes
Këndojnë bretkosat e moçaleve

Dje të kërkova kudo nëpër kujtesë
Por ti mungoje në vetveten tënde
Si t'i prek duart e tua
Kur u përngjajnë kallkanëve në dimër

Sa është i varfër njeriu në dreq të mallkuar
Sa është i vetmuar druri
Kur e lenë gjethet
Dhe mbetet peng i vetmisë

Çfarë të bëj sonte me duart e mia
Kur askujt si duhen
Çfarë të bëj me vetveten
Në këto çaste të ankthshme

NJË FLUTUR E KALTËR

Për befasinë time
Mbrëmë më pushuan dhembjet
Ndoshta ishe ti që erdhe kaq vonë
Të m'i shërosh plagët që kullojnë

Mbase s'ishe as ti e as hija jote
Por gjithsesi ishte një dorë e uruar
Që gjatë tërë kohës
M'i ledhatonte dhembjet

Ishe ti ose s'ishte askush
Por dikush shkeli nëpër shpirtin tim
Shkeli me hapat e padukshme
Një flutur e kaltër e ëndrrave të mia

SA HERË TË SHOH

Sa herë të shoh
Më shërohet çdo dhembje
Dhembja e ime e pafat

Nata më bëhet ditë
Kurse dita një melodi
Që vetëm një herë në jetë dëgjohet

Sa herë të shoh në ëndrrën time
Moj flutur e kaltër
Qielli më duket si një kokërr pluhuri

Sa herë të shoh mekem
Unë s'i përngjaj njeriut
Dukem si hija e jote e brishtë

NJËQIND VJET LARG KËSAJ DHOME

Sonte duhet të flemë
Dimri është larg
Njëqind vjet larg kësaj dhome
Larg ëndrrave tona i dëgjohet gjëma

Të thashë sonte duhet të flemë
S'do të lemë asnjë frymë
Të depërtojë në gjumin tonë
Duhet të jemi një duet i dyzuar

Mos harro vetëm sonte
Mund t'i kontrollojmë rritjet e drurëve
Nesër eh nesër
Dita e re nafaka e re

KY SHI I ÇMENDUR QË PO BIE SONTE

Ky zë i trishtë qenka zëri i erës
Ngjan me krrokëritjet e korbit
Kambana e vjetër në kambanore
Kuvendon me urtësinë e kryqit

Një dimër i ashpër në maja malesh
Rri kacule si bisha e egër
Poshtë në fshat cijatje zogjsh
Ka kohë që dëgjohen zërat nëpër dhoma

Një zë i trishtë ere
Po zbret nga përroi i qyqeve
Era përkëdhel trishtimin e ditës
Këtu s'paska mbetur më njeri

Do t'i hapim portat e mbyllura
Nuk do ta ngujojmë më ankthin
Ky shi i çmendur që po bie sonte
Do t'i marrë me vete të gjithë lumenjtë

GJITHÇKA PESHONTE SA DHEMBJA

Ora e vjetër në stacion sot qenka ndalur
Janë ndalur edhe lumenjtë
Nuk rrjedhin
Siç rridhnin dikur
Ky zë i sëmurë i erës
Kollitet si druri i moshuar

Ishte një dimër i zi i cili
Vetëm një herë në njëqind vjet
Kalon këtejpari
Dimri që i shkuli pemët në kopsht
I përpiu si gllënjkën e ujit malet

Por ne duruam
U rritëm dhe u burrëruam
Me dhembjen tonë të pashëruar
Prej një ane të rrugës
Kalonim në anën tjetër të frikës

Më pas shikonim ylberin
I cili në çdo kohë
Kacafytej me ankthin
Kacafytej si i çmendur
Me rrezet e veta të përndezura

Kurrë nuk kuptova
Se sa ishte ora atë ditë
Por ishte një ditë e padurueshme
E cila peshonte në shpirtin tim
Më shumë se dhembja
Më shumë se plagët e Gjergjit

MË THANË SE KISHA VDEKUR

Për herë të parë kuptova
Se tokës i vinte era trishtim
Dielli ishte përmbysur pas shtatë kodrave
Ku ishe ti të m'i shëroje plagët?

Të thirra u bëra zë pemëve
Askush nuk bëzani
Vetëm heshtja e kaltër si fluturat
Kalonte pranë qivurit tim të kalbur

Më thanë se kisha vdekur
Por unë edhe i gjallë dukesha si guri i zi
As gëk as mëk nuk belbëzuan pemët
Vetëm vaji i gjetheve dëgjohej në heshtje

Atë ditë qante edhe kokrra e kripës
Tokës i vinte era shije gjaku
Përmbysjet ishin aq të mëdha
Në shpirtin tim kaq të vogël

VETËM PËR MUA SONTE

Sonte vetëm për mua bie ky shi
Kësaj toke të bekuar
I vjen era bukë
Vetëm për mua sonte
Do të këndojnë zogjtë e korit qiellor

Ju thashë vetëm për mua
Do të bjerë ky shi i trentë
Aq të bukura janë sonte lulet
Sa që do të rritet një tjetër pemë
Në kopshtin e zërit të kitarës

Kjo muzikë hyjnore
Kjo natë e bekuar në zërin e erës
Kurrë më s'do të këndojnë zogjtë
Himnin e një dashurie
Nga e cila u rritën dy plepa madhështorë

KUR ME DËNESJE QANTE KITARA IME

Ishte një kohë e shthurur
Mendja e njeriut nuk punonte
I mora duart e erës
Dhe nga plagët e saj të pashërueshme
Thura një qivur prej shelgut të pikëlluar

Vetëm atë natë pashë se si qanin zogjtë
Qante edhe lumi i pezmatuar
Kur me dënesje qante kitara ime
Korbat ia merrnin në kor
Një kënge të hershme pagane

Më thanë se çdo dimër
Dëgjohet kori i trishtuar i erës
Lumenjtë mbufaten aq shumë
Sa që si sutat e egra
Dalin nga shtrati dhe vrapojnë fushave

Dimrat në Ballkan
S'janë si në vende të tjera
Edhe kur s'bënë acar
Këtu sa ora nga urrejtja
Ngrihen rrapet dhe gurët e stralltë
Njerëzit për të shpëtuar kokën

Si minjtë struken në thelbin e tokës
Nga palca e drurëve gjetherënëse
Si rrëshira e murrme kullon
Një lloj frike që s'ka të ndalur asnjëherë

MBASE KJO ISHTE NJË ËNDËRR

Mbi qivurin tim nga i cili
Për herë të parë
E largova kryqin e ditës
Krimbat filluan të hedhin
Një valle të çmendur pagane

Mbase kjo ishte një ëndërr
Ajo e kamotshme
Luajtën edhe rrënjët
Çmendurisht kërcyen kokrrat e pluhurit
Mbi rrashtën time të thyer qante era

Pakëz më tutje
Çuditërisht në syrin e uritur të lumit
Si një derr i egër kërcente vala
Kripa kishte marrë shijen e tokës
Kurse gjaku ia shkulte flokët erës

Si një shembje të ndonjë ëndrre
Ndjeva peshën e urisë
Urat s'kapërcehen më duke shkelur mbi to
Duhet të jesh korb ose pëllumb
Për të dalë matanë kujtesës

NË SYRIN E VASHËS MË TË BUKUR

Kam qenë
Çfarë s'kam qenë në kohën time
Si mollën e pjekur në degë
E kafshoja gurin

Nga sisa e pemës së egër
Isha në gjendje
Ta shtrydhja lotin e ditës

Po ju them se kam qenë
Si askush në rrethin tim
Zog i paprekshëm në fluturim

Në syrin e vashës më të bukur
Qiellin e shikoja
Si një rruazë blu
Dhe trastën time të kaltër
Me dashuri e mbushja me fatet e yjeve

Kur isha i ri
Ah, kur isha i ri
Edhe vetëtimave u bëja ballë
Sa herë që doja
I ndalja reshjet

Isha Zot
I zogjve në fluturim
Isha zëri dhe shpirti i erës

Isha njeriu që pemëve të egra
Ua shtonte gjethet
Që përgjithmonë të bleronin
Si sytë e kaltër të gjelbërimit

MBRËMË I PYETA TË GJITHA PEMËT

Cila këngë sonte për herë të parë
Do të ulet në sofrën time
Kam aq shumë dashuri
Sa që për të gjitha këngët
Do të shkruaj nga një poezi

Më kuptoni, miqtë e mi,
Kurrë s'kam qenë i lumtur
Sa në këto çaste
Ky diell i përskuqur më duket aq i afërt
Sa që do të mbytem në shpirtin e tij

Askush nuk më kupton
Kam shumë mall aq shumë
Sa që duan të më pëlcasin
Kapilaret
Nga kjo etje për jetën

Mbrëmë i pyeta të gjitha pemët
Për befasinë time
Nuk ma dhanë asnjë përgjigje
Hëna mbeti disi e stepur
Dhe shikonte tërë xhelozi

FLUTUROI EDHE LEJLEKU I FUNDIT

Mbrëmë në fund të qytetit
Përgjumej një plep i dehur
Si lule mollët do të çelin nesër
Pemët e fishkura të lagjes

Në pijetore vallëzojnë gotat e dehura
Kamerieri dënes mbi banak
Kurse stoli në parkun e vjetër
Ëndërron të vetmin gjeth që u këput nga dega

Ndoshta sonte askush s'qenka dehur
Secili shikon gotën e verdhë
Një zbrazëti e paparë
Qenka kredhur brenda kujtesës

Mos m'i ngacmoni pemët në kopsht
Zogjtë do të mbeten pa folé
Fluturoi edhe lejleku i fundit
Nga një çati e rrënuar e lagjes

KISHIN IKUR EDHE QIVURET

Sa qesharake më duken sonte pemët
Asnjë fjalë nuk mbeti
Nga poezia ime
Ku më mbetën miqtë
Lejlekët e mi të murrmë

Për befasinë e të gjithëve
Kishin ikur edhe qivuret
Për herë të parë rastisa në jetë
Varre të murrmë lakuriq
Dhe njerëz pa emër nëpër epitafe

Ky qytet nuk paska asnjë pijetore
Mbushur me njerëz të dehur nëpër rrugë
Çfarë trishtimi pranë vitrinave blu
Sa që sytë lëbyren
Nga këto pamje apokaliptike

DIKU NË MAJA GJETHESH

Çfarë të bëj me këtë tatuazh të dhembjes
Të gjitha udhët
Si plagët e erës më mbetën peng
Të kujtohet: ishte dimër kur vdiq pema
S'patëm kohë
As t'i varrosnim kujtimet

Të thashë ishte dimri i pështirë
Kur acari na i ngriu pemët
Kot i mbështollëm me kujdes
Rrënjët e kujtesës
Atë çast
Era na i përpiu domethëniet

S'mbeti asnjë shteg për tatuazhe
Tërë dhembjen e fundosëm
Në lëkurën tonë të regjur
Pemët në kopsht s'çelën asnjë lule
Diku në maja gjethesh
Dëgjohej një gjëmë e trishtuar e vjeshtës

KY QYTET I PËRGJUMUR

Qyteti im mbrëmjeve të vona
Ka disa fytyra
Fare qartë duken hijet e brymta
Por kurrsesi nuk mund t'i njohim

Njërën fytyrë me xhelozi
E ruan për në shtëpi
Kurse me fytyrën tjetër të shfrenuar
I pastron banakët e pijetoreve

Ky qytet i shtatë çudirave
Fare mirë i njeh shtëpitë me drita të kuqe
I njeh edhe rrugët
Kur takohet me vetveten

Ky qytet i përgjumur
Për çdo mbrëmje fle në shtratin e vdekjes
Kurse të nesërmen zgjohet esëll
Ngjan me kokrrën e pjekur të shegës

Ky qytet i ëndrrave të mia
Ndonjëherë ngjan me lakuriqët e natës
E ndonjëherë nuk është në gjendje
T'i ngjajë as vetvetes

VETËM SI ORA E VJETËR

Fqinji im çdo mëngjes
Zgjohet si një gjinkallë
Rrufit disa kafe
Dhe më vonë shikon eklipsin e diellit

Në çdo kohë është në gjendje
Të grindet si një mace e lazdruar
Më pas qindra herë në ditë
Si një fëmijë çamarrok kërkon falje

Atë ditë kur nuk shkruan asnjë poezi
Në mbrëmje fle më i qetë
Vetëm si orës së vjetër
Kohë pas kohe i trokasin dhëmbët

Dikur vonë kur e tërë bota fle
Ky njeri nëpër shtjellat e ëndrrave
I kërkon burimet e pazbuluara të lumenjve
Që nuk shterojnë asnjëherë

Një copë ëndrre mbi pasqyrë

Cikli i dytë

ISHTE NATË OSE NUK ISHTE AS NATË E AS DITË

Më duhet vetëm një fjalë
Që të bëhem njeriu i pijetoreve
Heshtja më vret sonte
Më shumë se njëqind plumba
Ti edhe ashtu nuk je në gjendje
T'i kontrollosh ndjenjat e tua

Ngjan me lepurin e frikësuar
Në kopshtin zoologjik
Kobra në anën tjetër të kafazit
I ka vendosur syzet e errëta
Ky pelegrinazh frike përhapet
Si murtaja e zezë

Ishte natë ose nuk ishte as natë
E as ditë
Ishte diçka mes frikës dhe guximit
Qëndronte si teli i urrejtjes
Në hapësirë
Qëndronte i ngrehur
Në harkun e një çasti tragjik

Kjo rrugë e dyshimtë
Zbriti nga monopatet e bjeshkëve
Asnjëherë më nuk menduam
Se hijet vdesin
S'menduam as për vdekjet e drurëve
Një tel i ngrehur prej fjalëve
Lëshonte nxehtësi deri në shkrirje

ÇDO GJË ISHTE E KALTËR NË ATË KOHË

Aq shumë heshti gjuha
Sa që ngjante
Me shollën e arnuar
Këpucët e mia
Nuk u ngjanin më këpucëve
Nga thonjtë e thyer
Pikonte një qelb kundërmues

Të thashë se fati s'ishte në anën tonë
Çdo gjë na shkoi mbrapsht
Edhe pemët kur i mbollëm
S'patëm pikë uji
Për t'i zgjuar ndjenjat e fjetura të rrënjëve
I shkundën mjegullat

Nga drurët e izoluar
Nuk pritëm asnjë shpëtim
Dimri ishte i zi
Dhe aq shumë zgjati sivjet
Sa që na u duk
Sikur kurrë nuk do të kthehet pranvera

Por pranvera erdhi
Zogjtë u ngjanin fluturave
Të kaltra si qielli
Çdo gjë ishte e kaltër atë ditë
E kaltër
Si letrat e kaltra të dashurisë
Në rininë tonë të hershme

Prishtinë, 17 shtator 2015

SA HERË QË NDRYSHON MOTI

Një tel i ndryshkur argjendi
Kitara e varur në lagështinë e murit
Dhe një njeri i vetmuar
Bisedon në heshtje
Me amalgamën e pasqyrës

Në oborr veç ka vdekur bardhësia
S'lëviz asnjë gjethe mani
Një mushkonjë e bezdisshme
Si somnambul sillet përreth
Dhe i zgjon portat e fjetura

Paska vdekur edhe frymëmarrja
Një lule në vazo
Mbjellë nga dora e kushedi kujt
Me vite të tëra
Nuk e ndal gjëmën e saj

Nuk ndalen as dhembjet e shiut
U ngjajnë sëmundjeve reumatike
Sa herë që ndryshon moti
Si trokitjet nëpër porta të rënda
Ofshajnë stinët dhe eshtrat

NJË COPË ËNDRRE MBI PASQYRË

Një copë mjegulle
Dhe pakëz shi në brendinë e pasqyrës
Nata ulërin kalldrëmeve
Ulërijnë edhe kontejnerët e mbushur
Nëpër rrugët e qytetit lehje shirash

Asnjeri nuk banon
Përpos vetmisë
Në këtë shtëpi të zbrazët
Çfarë mund të kërkojmë këtu
Ku vdesin lulet pa sythuar asnjë gonxhe

Një gotë e thyer mbi tavolinë
Përjeton katarsisin e fundit të jetës
Mbase hija delikate
E kamerierit
I kish lënë shenjat e gishtërinjve

Një copë ëndrre mbi pasqyrë
Dhe pasqyra gozhduar
Përballë ëndrrës
Shikojnë të tmerruar
Se si zbret dita nga shkallët e kujtimeve

SA PAK TË DUHET SONTE

Sa pak të duhet sonte
Që këtë heshtje mortore
Ta shndërrosh
Në një zhurmë që e çmend edhe gurin

Sa pak të duhet sonte, o poet
Sa pak
T'i shtrydhësh mjegullat në një gotë
Dhe të dehesh me sirenat e deteve

Sa pak të duhet sonte
Miku im
Sa pak
Që t'ua vesh shpinën këtyre maleve

Sa pak të duhet sonte
Miku im sa pak
Ta zbusësh bishën që fle te ti
T'i shtrydhësh mjegullat nga loti i hënës

Sa pak të duhet sonte
Miku im poet
Sa pak
Për t'u shndërruar në përmendore

SHIKON SI PËRFLAKET JUGU

Një lule e fishkur në kalldrëm
Pranë saj një njeri i dehur
I përqesh kalimtarët
Dita e zhytur në pikëllim
Përjeton metastazën e vdekjes

Tej Urës së Gurit një gjysmë toni bronz
Me nostalgji shikon guralecët
Lumëbardhi si dhëndri krenar
Shikon si përflaket Jugu
Në sytë e vashave të reja çelin zambakët

Një njeri i përhumbur
Nëpër thellësitë e xhepave të grisur
I kërkon letrat e dashurisë
Kalaja me tërë madhështinë e saj
Përsiat për betejat e humbura dhe të fituara

Kurse një korb si flutura e kaltër
Vrapon prej lules në lule
Dielli me xhelozi përcjell lojën e ditës
Në valët kaçurrele të lumit
Ura e vjetër gjuajti dorashkën në fytyrën e ditës

JANË RRALLUAR EDHE LYPSARËT

Ja një flutur e kaltër
Në një degë të thyer
Ka kohë që nga qyteti im
Ka ikur pranvera

Po ikin edhe lejlekët
Ndoshta ky dimër do çmendet sivjet
Nëpër trotuaret e qytetit
Janë rralluar edhe lypsarët

Po largohen kush mund të ikë
Vetëm oxhaqet qëndrojnë pingul
Kurrë nuk iu dorëzuan asnjë tufani
S'patën frikë edhe nga bombat vrastare

Ky dimër i madh
Duket edhe më i madh në këtë vjeshtë
Pemët kanë rënë në gjunjë
Dhe lusin Hyjin që të mos ndodhin vërshimet

MBASE NA ZURI NË BEFASI

Ka ca kohë
Që shpesh na zgjojnë ankthet
Si të dehur
Mbahemi pas ndonjë peme
Dhe tok me erën
Ia shkulim rrënjët e frikës

Shiu i zi s'pushon kurrsesi
Çfarë s'bie nga hapësira e murrme
Bien paprerë
Anijet kozmike
Dhe avionët prej letre
Shiu imcak i përcjell me një melodi
Këto reshje atmosferike

Sivjet shumë më herët ikën zogjtë
Asnjë lejlek nuk na mbeti mbi çati
Ndoshta ky dimër
Ka për të qenë tepër i ashpër
Mbase na zuri në befasi
Ose vetë ne
Përherë jetuam dhe jetojmë në amulli

I HAP SYTË E MBYLLUR

Shpeshherë s'mund të fle
Nuk më zë gjumi
Paskan ikur zogjtë
Asnjë ëndërr pranë mirazheve

I hap sytë e mbyllur
Kudo zbrazëtia e errët
Si i dehur prek ajrin e tendosur
Këputen telat e ndryshkur të kitarës

Në shpirtin tim - dimër
Jashtë nën pemët e ngrira fryn murrlani
Era si një anije e fundosur
I uli flamurët në gjysmështizë

Vetëm disa zëra të huaj
Dëgjohen nën pemët e dhunuara
Shtreza e fundit e këtij dimri
Po i lan sytë me mëkatin e së kaluarës

KJO KOLLITJE E DRURËVE

Në këtë të ftohtë të acartë
Nuk kam më dëshirë të çapitem
Laureshat e murrme
Po i mbledhin
Kokrrat e fundit të misrit

Dimri me fërfëllizë
Po i shkul rrënjët e rrapeve
Meqë lejlekët ikën kaq herët
Diçka e zezë
Po përgatitet sivjet mbi kokën tonë

Kjo kollitje e drurëve
Asnjë çast nuk tulatet
S'reshtin as gjëmat e dheut mëmë
Përtej imazheve të verdha
Po shkulen rrënjët e drurëve

S'dorëzohet dot Drenica
Që në djep i ka lyer pushkët
Gjallë është djemuria
Dykrenorët legjendarë
Janë shigjetarë në Fushën e Mëllenjave

SIVJET NDOSHTA NUK PËRSËRITET GJËMA

Asnjeri në pijetore
Vetëm gotat e dehura vallëzojnë
Valsin e fundit të kësaj vjeshte
Era si e babëzitur
I rreh qepenat e drunjta të lagjes

Mollët veç janë pjekur
Asnjë kokërr s'ka mbetur nëpër degë
As mushkonjat nuk duken më
Mbase vjeshta i numëron
Çastet e fundit të stinës në vdekje

Për çudi s'dëgjohen as lehjet
Vetëm aty - këtu ndonjë mjaullimë maceje
Tregon sa në prag janë çiftëzimet
Nën çatitë e vjetra
Dëgjohen britmat e strehëve

Sivjet ndoshta nuk përsëritet gjëma
Drini i Bardhë ka kohë që duket i lodhur
Kushedi sa vjet kaluan mbi të
Herë kollitet nga ndonjë dhembje
E herë pështyn ironinë e tij të madhe

AJO NUK I NGJANTE MË NJERIUT

Me tërë mllefin e saj ajo i truante
Çastet kur u pamë me të
Nga shpirti i përvuajtur si rrëke
Buronte një pezëm i paparë

Donte të heshtte të mos truante
Por ec e ndale atë tërbim shpirti
Që ngjante
Si një krater i egër vullkani

Herë pështynte vrer
E herë pezëm
Rruga nga doli ishte e gjatë
Ishte rruga e plagosur e urrejtjes

Thonë se shumë dashuronte ajo grua
Aq sa dashuria e saj
U shndërrua në një gjarpër me nëntë kokë
Ajo gjithnjë e më shumë i ngjante njeriut

KY SALEP KOSOVE

Mbrëmë në prehrin e brigjeve
Përgjumej Lumëbardhi
Algat këndonin një serenatë pagane
Zambakët për herë të parë i çelën sytë

Çelën edhe lulet e tjera
Kalldrëmet kuvendonin me qepenat e vjetër
Shitësi i salepit sa mundej
I thërriste myshterinjtë

Urdhëroni salep me shije dashurie
I ëmbël dhe i ngrohtë
Salepi i Prizrenit
Me madhështi gruri dhe dashuri njeriu

Përtëritet plaku plaket i riu
Ky salep Kosove
Në botë s'ka të dytë
Urdhëroni myshterinj mos i mbyllni sytë

MUND TË JEM EDHE NJË BRITMË

Çdo gjë mund të jem në tokën time
Pemë e njomë
Ose një rrap shekullor
Bukë e gatuar shtatë herë për të vonuarit

Jam mollë pranvere dhe vjeshte
Të afërmit mund të më kafshojnë
Si të duan dhe sa të duan
Por për të huajt jam strall graniti

I ngjaj Kosovës sime
Sa bujar po aq edhe i vrazhdë
Për mikun mik deri në pafundësi
Kurse për armikun një gjarpër i zi

Jam njeri si të gjithë njerëzit
E kësaj bote
I butë si ëndrra e fëmijëve të porsalindur
Dhe i ashpër si fjala e dhënë e një burri

Mund të jem edhe një britmë
Pjergulla me rrushin e verës së kuqe
Jam gjithçka dhe urë për udhëtarët
Por edhe varr për ata që shkelin fjalën

NËN KËTË PLIS

Nën këtë plis
Ndjehem si lis
Dardan me gjak të kulluar
Të më kenë lakmi diell e hënë
Ashtu siç më patën zili perënditë paganë

Nën këtë plis
Të bardhë si dëbora e Sharrit
Ndjehem si lis
Le të më ketë zili edhe Hyu
I cili për kombin tim e pat qëndisur

Nën këtë plis
Përherë ndjehem si lis
Jam më krenar se vetë krenaria
Sepse e mbajmë në kokë shumë më herët
Se sa lindi vetë Gjithësia

U PËLQEN HESHTJA

Mbrëmë kuptova
Se shtatoret kishin sy të bronztë
Nga qeshja e tyre krenare
Pikojnë betejat
Pikon e ardhmja
Kur në mendime u zgjohet e nesërmja

Nuk bërtasin asnjëherë
Ngjajnë me perënditë
U pëlqen heshtja
Sepse bash në heshtjen e tyre
Me tërë madhështinë e një ngadhënjimi
Fle krenaria njerëzore

Në çdo vend, kudo që ndodhen
Nga shikimet e tyre
Pjalmon një dritë e përflakur
Shtatoret e qytetit tim
Nuk di
A e meritojnë vallë shpërfilljen tonë

NGA DRITARET E MBYLLURA

Aq shumë zogj kam parë në jetë
Sa që s'isha në gjendje t'i numëroja asnjëherë
Sytë e mermertë të ditës sot u ngjajnë
Shikimeve abstrakte të pasqyrës

Në dhomën time binte një shi i grisur
Binte me stërkala si ëndrrat e mia
Nga dritaret e mbyllura
I përshëndeta trenat e fundit të mëngjesit

Kudo ndjej dhembje në qenien time
Trishtueshëm më dhemb frymëmarrja
Eshtrat kërcasin nga sëmundjet reumatike
Kërcasin si kokrrat e kripës në zjarr

Qëndroj si guri i mallkimit
Nuk më lëvizin duart as koka
Dhe asnjëherë s'kuptova
Sa zogj shkuan dhe erdhën në qytetin tim

ECIM NËPËR MONOPATE DHEMBJESH

Përditë vdesim nga pak
Vdesim si elefanti
Nga fytyra e drurit metaforik
Ngjizim mirazhe
Dhe më pas udhëtojmë drejt një drite

Ecim nëpër monopate dhembjesh
Si për mahi i shkulim pemët
Herë na pëlqejnë vdekjet
Herë lindem
Për të vdekur sërish

Kurrë nuk i ngjajmë vetvetes
Orë e çast ndryshojnë ndjenjat tona
Herë vdesim si njeri
E herë si ndonjë jashtëtokësor i verbër
Por gjithsesi vdesim vertikalisht

Ne për çdo ditë vdesim nga pak
Ose sërish lindim për një vdekje të re
Domosdo u ngjajmë fosileve
Dhe ëndrrave të murrme të lashtësisë
Vdekja jonë hulumton udhëtimin e pasosur

NËPËR SINORË KANË DALË LEGJENDAT

Gjysmë kryqet e thyera
Dhe varret e vithisura
Jetojnë me kambanën
Korbi i bardhë në sqep i varros arkivolet

Nga Bjeshkët e Nemuna si ujëvarë lëshohen
Zërat e lashtësisë
Nëpër pijetoret e përgjumura
Zgjohen honet kobzinj

Lahutarët e vjetër përherë në iso vajtojnë
Gajdet shqyejnë gurmazin e pemëve
Nëpër sinorë kanë dalë legjendat
Dhe kullosin nëpër dhembjet e atdheut

Një kryq i coptuar në qindra cifla
Në pelegrinazhin e etjes
Qëndron burrërisht ballë përballë
Me varrin e dhunuar të një legjende

ECTE EDHE URIA

Përpos trastës së shqyer
Asnjë shpresë nuk ka ushtari i plagosur
Nëpër fletët e shqyera të ditarit
Si zogjtë e verbër fluturojnë plumbat

Iku edhe një ditë e plagosur
Në brendinë e rrapit vajton zgërbonja
Çeta në kolonë ëndërron bukën
E buka piqet në thellësi të maleve

Në shpirtin e dhembjes përkundet plaga
Në heshtje mortore
Dëgjohet zëri i trastës së uritur
Buka gatuhet larg e sa afër i kemi plumbat

Ec kolona nëpër sterrën e tunxhtë
Kalamendet edhe uria
Si zogjtë e shpërndarë fluturojnë plumbat
Jeta nuk vlen as pesë qindarkë

Prishtinë, 18 shtator 2015

MBASE ISHTE LARJA E NDËRGJEGJES

Si sfinks i egër prej mermeri
Qëndronte përballë teje
Përjargej nga lakmia
Disa herë e mashtroi kryqin përballë njeriut

Sërish e sërish vazhduan gënjeshtrat
Pilati si një derr zgërdheshej
Darka nuk ishte e fundit
Por e para e ligësisë së sëmurë

Më pas u bë mbrëmje
Sytë u errësuan
E tërë sterra pikonte pikëllim
Sërish u dëgjuan zgërdheshjet

Një njeri i vogël i fërkonte duart
Mbase ishte larja e ndërgjegjes
Më tej në hon u krodhën zërat
Një kryq në Golgotë shikonte perëndimin

DHE SËRISH NGA FILLIMI DOLI NJË TJETËR FILLIM

Në brendinë e faqeve të librit të shenjtë
Dëgjohej fërshëllima e erës
Një korb i çmendur në kambanore
Nuk i ndalte krrokëritjet

Nata ishte e gjatë sa pritja
Përtej asaj gjatësie
Në çdo kohë lindnin dhe vdisnin
Fluturat e kaltra të fëmijërisë

Shikoj përreth meje
Ngarendin njerëz me shpresa të humbura
Asnjë pulëbardhë nuk fluturoi
Mbi kiçin e thyer të anijes

Një peshkaqen i uritur kafshonte bregun
Në syrin e peshkut të artë
Vdiste shpresa e fundit e ditës
Dhe sërish nga fillimi doli një tjetër fillim

POR TË KOTA ISHIN LUTJET TONA

Nga na erdhën këta korba
Nga cila vdekje dolën të ligat
Anija e fundosur
Më në fund e lëshoi spirancën

Asgjë s'na mbeti përpos makthit
Ulërinë ujqërit në pragjet e dyerve
Pemët u përgjunjën me sy nga qielli
Rifilluan me lutjet pagane

Asnjëherë nuk kuptuam se cilit Hy
Iu lutëm me mijëra vjet
Por të kota ishin lutjet tona
Kurrë s'na dëgjuan perënditë

Vetëm korbave të dehur
Natë e ditë u dëgjoheshin krakëllimat
Era e përgjunjur shikonte qiellin
Se si sterrohej aq sa verboheshin yjet

Nga cili qiell zbritën të ligat
Kush do na rrëfejë për udhën tonë të trishtimit
Një zë i lashtë nga brenda ngriti kokën
Dhe i theu të gjitha portat e mbyllura

ASNJË ZË NJERIU

Më duket se gjërat që kishin
Dje një kuptim
Sot paskan mbetur lakuriqe
Ashtu nudo
Të venitura si lulet e dimrit

U ngjajnë kazermave
Të së kaluarës
Pa asnjë njeri përbrenda
Vetëm erërat e çmendura
Ndonjëherë marrëzisht
Fryjnë nga të katër anët e dynjasë

Të zbrazëta si ëndrrat
Janë edhe ditët tona në vijim
Bredhin pa kurrfarë shprese
Rrugëve qorre
Dhe në fund të sokakut
Takohen me parathëniet e pakuptimta

Nuk dëgjohen më as lehjet monotone të erës
Asnjë zë njeriu
S'del nga brendia e guaskës
Deti i përmbytur si anijet e piratëve
Kotet tok me balenat e bardha
Në diellin e përskuqur të Adriatikut dënes era

ISHTE KOHA E TË PAKOHËVE

As mbrëmë nuk u ndalën
Trokitjet nëpër dyert e lagjes
Dëgjoheshin edhe britmat e erës
Një korb djallëzor krakëllinte te plepat

S'pushonin as piskamat e lisave
Qielli i ngrysur i shkulte flokët
Kurse burrat sipas një zakoni të lashtë
I grithnin fytyrat e mavijosura të pemëve

Mjegullat zbritën deri në tokë
Për herë të parë zunë të shterin edhe krojet
Asnjë pikë uji s'kishin lëfytet
Nga degët e pemëve çurgonte nostalgjia

Më duket se kjo kohë ishte një tjetër kohë
Ajo që ngjallte trishtim në shpirt
Ishte koha e të pakohëve
Koha e djajve të netëve ballkanike

BËRLYKEJ EDHE ERA

Kohë e ngarkuar me vapë
Shtatoret anemike shikonin në pafundësi
Nën degët e pemëve të shartuara
Përvidheshin rrezet e para të mëngjesit

Shtreza i kishte humbur rrugët
Qante nën hijen e trëndafilave
Një trishtil i vetmuar
Këndonte mbi trungun e tharë të thanës

Një idil i paparë deri më sot
Fshati shtrihej në shuplakat e mjegullave
Vetëm dy lejlekë të bardhë
Ia kishin behur në çerdhen e vjetër

Përroi i përgjumur i lante sytë
Një kaproll brithyer bërlykej pandërprerë
Bërlykej edhe era
Në maja malesh buzëqeshte pranvera

MERRE CILËNDO QOFTË

Nga i njëjti trung
Na duhet t'i këpusim dy lule
Po pate guxim
Ec e preke njërën prej tyre

Me njërën mund të dalësh në dritë
Kurse me tjetrën
As në Purgator s'do të kesh vend
Preke njërën po pate kaçik

Mos u frikëso merri erë lules
Cilëndo qoftë
Afroje te shqisa e të nuhaturit
Njëra është jeta ndërsa tjetra - vdekja

Merre cilëndo qoftë
Merre atë pa të cilën s'mund të ekzistosh
Nga njëra lule lind vdekja
Kurse nga tjetra si ujëvarë buron jeta

NATA NË QYTETIN TIM

Gjërat qenkan zhveshur në këtë lagje
Pemët duken si pikturat surrealiste
Mbase nga shpirti i tyre i virgjër
Pikon një balsam për shërimin e mendjes

Po ashtu edhe njerëzit
S'duken aspak më mirë
Pamja e tyre si karikaturë
Na bën të qeshim me vetveten

Një mace e zezë katran
Paska veshur lëkurën e natës
Prej këpucëve të saj prej letre
Kundërmojnë rrugicat e ngushta të qytetit

Orë e çast këtu ndryshon moti
Herë bie shi i metaltë
E herë nga çatitë e tymosura
Pikon përditshmëria e bezdisshme

Kështu që edhe të kuqtë e buzëve
Duken më të kuq në degët e shelgut të pikëlluar
Nata në qytetin tim
Disa herë i ndërron këmishët e fjetjes

BRENDA NJË FJALE TË VETME

Përbrenda vetëm një fjale
Mund të burojnë menjëherë
Të gjithë detet
Si zvarranikët të zvarriten malet
Vetëm brenda disa çasteve
Udhët derdhen tok me lumenjtë

Brenda një fjale si uragani i tërbuar
Shpërthejnë luftërat
Shërohen dhe pjalmohen
Të gjitha llojet e sëmundjeve
Brenda një fjale
Lindin dhe vdesin perënditë

Brenda një fjale të vetme
Njerëzit si në ndonjë ëndërr
Shndërrohen në bisha
Dhe anasjelltas
Brenda një fjale në Ballkanin e çmendur
Lindin dhe përmbyten fjalitë

Kësaj nuk i them dot liri

Cikli i tretë

KUSHEDI SE NGA KUSH

Atë ditë befasisht
Mu shthurën mendimet
Atdheu më dukej tejet i varfër
Më dukej si një luadh pa zot
Ku mund të kullosnin pa frikë
Bishat e të gjitha llojeve

Në shikim të parë
Më dukej si një vresht pa sinor
Kushdo që kalonte
Lodronte si derri i egër

Ku nën pemët e dhunuara
Si zogj të plagosur
Dukeshin flamujt e grisur

Ose të jem i çiltër
Asnjëherë askund nëpër shtylla
Nuk pashë
Se si valonin flamujt

Ato ditë të para të luftës
Flamuri për ne
Ishte një nocion i huaj
Vetëm mund ta përfytyronim
Se si do të dukej e nesërmja

Ende nuk e kam të qartë
Se nga kush u frikësuan njerëzit
Por një mëngjes herët
Dykrenori befasisht
U largua nga fusha e përgjakur

Dhe të nesërmen
Nëpër shtyllat e djegura pamë
Kushedi se nga kush
Një tjetër fushë të hamendësuar

NJË LLOJ GJAKU NGA I CILI...

Të uritur
Të grisur dhe të rraskapitur
Parakalonin flamujt
Nëpër qendrën e zbrazur të qytetit
S'dëgjohej asnjë zë njeriu

Mbi çatitë e dhunuara
Dëgjoheshin vetëm krrokëritjet e korbave
Një zë i shterur i një moshuari
Truante ditën
E cila si zvarranik i plagosur
Zvarritej mbi asfaltin e zhuritur

Në Kodrën e Trimave
Me flamuj prej letre vraponin fëmijët
Të rriturit strukeshin si ushejzat
Nëpër lagështit e mureve
Dita dukej aq e sëmurë
Sa që lëngonte tmerrësisht
Nga një sëmundje që po avitej

Më kujtohet
Apo fare mirë më kujtohet
Shiu imcak i asaj dite
Që acaronte një tjetër plagë
Mbi plagët
E ushtarëve që kullonin
Një lloj gjaku nga i cili
Edhe një kohë të gjatë do të vuajë mëmëdheu

KËSAJ NUK I THEM DOT LIRI

Do të ecim
Domosdo duhet ecur
Kësaj gjendjeje nuk i them dot liri
Ajo ka një pamje krejtësisht tjetër
Duhet të duket si një ëndërr e paparë

Ky nocion asgjë s'ka me të sotmen
Flamujt e grisur nëpër skuta
Po na i verbojnë verbëritë e syve
Çfarë të bëj me këto mirazhe të grimcuara
Kësaj nuk i them dot liri

Atë mund ta krahasojmë me nuset e maleve tona
Krenare si zogu i shenjtë
Kurse kjo që po e shoh kaq të mjerë
Ka pamje krejtësisht tjetër
Edhe sytë i paska të ngrysura si flamujt

Më falni por kësaj nuk i them dot liri
Më herët pata një tjetër flamur
Po ashtu edhe një tjetër emër
Që më flinte në zemër
O boboo mjerisht
Sot u zgjove kosovar

POR TI ASNJËHERË NUK E ULE KOKËN

Kaherë e kam ditur
Se je si një zog i shenjtë
Je nocioni i lirisë
I përket vetëm kaltërsisë së qiellit

Flamuri im i grisur
Edhe kështu të dua më shumë se jetën
Po aq krenar me ty hyri djemuria në luftë
Hyri dhe doli nga betejat faqebardhë

Në çdo kohë të gëzuar dhe të pikëlluar
Ty të mbante në zemër
Ishe shpirti dhe fama e Gjergjit
Flamuri im dykrenor

Sot të shoh disi të përbuzur
Pranë teje valon një tjetër bastard
Por ti asnjëherë nuk e ule kokën
Më krenar se kushdo tjetër dole nga betejat

ERA U BINTE DAULLEVE TË KUSHTRIMIT

Nëpër rrugë harta dhe fytyra të grisura
Një ushtar me trastë të lodhur
Dëgjon psherëtimën e lisit
Asnjë hutin nate
Nuk u ndal te pemët e djegura

Ishin ato vite të vdekjeve
Dhe ajo ditë e trishtë e lindjeve
Një kohë e cila dështoi vetveten
Nga shtërzimet e dhembjeve
Mjegullat i zbrazën kazanët me breshër

Atë ditë askund nuk u dukën flamujt
Era u binte daulleve të kushtrimit
Zërat e pemëve si nëpër përralla
U strukën në shpirtra, në rrënjë
Një qyqe e verbër
Gjatë tërë natës nuk e ndali vajin

Ishte nata e cila nuk harrohet
Bataretë e njëpasnjëshme
Kositnin barin e njomë
Edhe vdekja ishte aq e njomë
Sa që me kilometra i dëgjohej aroma

S'DORËZOHET PREKAZI GJALLË

Këtu qenka ndalur dielli
E paska rënë në provim njerëzimi
Pemët s'marrin frymë
Çatitë në gjunjë
Orë e çast regjistrojnë
Masakrën e paparë çnjerëzore

Një foshnjë e çoroditur
Me habi shikon gjymtyrët nëpër skuta
S'bëzan nga frika e as nga tmerri
Dhembja këtu nuk ka vend
Ademi piskat
S'dorëzohet Prekazi gjallë

S'pushojnë breshëritë e automatikëve
I zoti i shtëpisë
Me krenari i pështyn plumbat
Vdekja këtu s'paska vend
S'dorëzohet Prekazi gjallë
S' dorëzohet atdheu sot

TYTAT KËNDOJNË NË ISTIKAM

Plumbat dhe shrapnelat
Mbetën si skelete cofëtinash në lëndinë
Ku kohë pas kohe
I dëgjojmë krakëllimat e korbave
Mbase këtu paska përfunduar beteja

Pak më tutje një tjetër betejë
Sapo ka filluar
Pemët në gatishmëri dhe gjethet gojëhapur
Presin që të marrë fund sulmi
Vdekja e përbuzte armikun

Një zë nga varri çohet peshë
Çohet si nga ndonjë legjendë
Dhe u del përballë armiqve
Prej tij tmerrohen për vdekje
Gurët e murrmë dhe drurët halorë

Tytat këndojnë nëpër istikame
Këndojnë dhe presin vdekjen
E cila u del përballë
Të gjallëve të vdekur
I del përballë djemurisë që s'e njeh frikën

OSE GJYSHI I GJYSHIT TIM

Udhëtova as vetë nuk di se sa
Besoja se do t'i gjeja shtëpitë që i lashë dikur
Por jo, kisha gabuar
Asnjë çati nuk më njohu
Të gjitha dyert ishin të mbyllura

Nuk më njohën as qentë e mëhallës
Askush nuk më vështronte
Në lagjen time isha tërësisht
Një njeri i huaj
Edhe strehët më shikonin me mosbesim

U thashë njerëzve se nuk erdha
T'ju kërkoj asgjë
Më thirri atdheu
Më thirrën zërat e gjyshërve të vdekur
Por askush nuk më besoi

U ula të marr pakëz frymë
Mbi një rrasë të zezë
Drurët dhe njerëzit ma kthyen shpinën
Vetëm një varr i vithisur
Nga thellësitë ma zgjati dorën

Ndoshta ishte ajo dorë e uruar e gjyshit,
Ose e gjyshit të gjyshit tim prej nëne
Ose gjyshi i gjyshit të tim prej babës
Por më në fund pas moskokëçarjes së njerëzve
Ai varri i vithisur m' i ndezi dritat e shpresës

GRUMBUJ LETRASH ME POEZI

Mbi tavolinën time të punës
Një qiri i ndezur
Dhe grumbuj letrash me poezi
Aty afër taketukes një libër i trashë
Mbase është "Lufta dhe paqja"

Asgjë s'ndryshon nga koha e Tolstoit
Më duket se janë të njëjtët personazhe
Dikush ankohet nga kokë dhembja
E dikush tjetër luan me gjymtyrët e veta
Një mushkonjë e bezdisshme vetëm zukat

Dritaret herë hapen e herë mbyllen
Me të njëjtin ritëm që dikton era
Letrat e shkruara
Dhe ato të pashkruara
Asnjëherë nuk arritën në adresën e duhur

Ndërsa tavolina ime e punës
Përditë përsiat në heshtje
Në qytetin tim as luftë e as paqe
Çdo gjë është diku në mes të udhës
Përpos taketukes prej argjile që kundërmon

VARRTARË TË DALË NË PENSION

Këto porta të vjetra ka kohë
Që përfunduan nën dhëmbët e molave
Po ashtu edhe pragjet
U kalbën nga dhëmbi i kohës

Plepat njëlloj si njerëzit ecin të kërrusur
Si nofullat e pleqve po dridhen gjethet
Nga rrënjët largohen edhe urithët
Një dyndje gjallesash ngjan me lagjen tonë

Kalojnë rrugëve të kalldrëmta
Ushtarë dezertorë dhe profetë të dështuar
Varrtarë të dalë në pension
Dhe klounë të dehur që në mëngjes

Njerëz me disa pasione të sëmura
Dhe farkëtarë fatesh
E gjithë kjo katrahurë e mendjes
Po kalon nëpër metastazën e trishtimeve

KËNDON EDHE MËNGJESI I DEHUR

Zëri i pa artikuluar i erës
Ka humbur disi vrazhdësinë e vetvetes
Ngjan me gërhitjen
E teneqesë së ndryshkur
Nga pullazi i një shtëpie të vjetër
Çdo mëngjes dëgjoj korin e bretkosave

Kalimtarët enden si të përhumbur
Bredhin me kokë të fshehur nën kapelë
Gjinkallat asnjëherë nuk pushojnë
Në këtë qytet
Nga aroma e shijes orientale të qofteve
Këndon edhe mëngjesi i dehur

Asnjë ditë këtu asnjëherë
Nuk i ngjan më ditës tjetër
Secila ngarkohet me një ngjarje
Derisa ullukët e metaltë
Si të dehur përcjellin hap pas hapi
Melodinë e trishtuar të shiut

Prishtinë, 20 shtator 2015

ASNJË GJETHE NUK PASKA MBETUR

Sa herë që shikoj zbrazëtinë
Për habinë time
Dikush troket në dritare
Troket dhe zhduket si frika
Pas krakëllimave të para të korbave

Plumbat nuk dinë të ndalen në këto çaste
Fluturojnë si lakuriqët e natës
Një zë i zhveshur deri në asht
Mjaullin si era
Mjaullin pandërprerë edhe druri i moshuar

Asnjë gjethe nuk paska mbetur
Në këto degët e thyera të ditës
Kjo pemë e zhveshur mbase po vuan
Nga një sëmundje e panjohur
Po vuan nga një anemi e pa deshifruar

NJË GJYSMË PLUMBI

Sonte çdo gjë qenka përgjysmuar
Një gjysmë gjëme
Nuk vlen për asnjë gjysmë loti
Edhe kjo pemë qenka përgjysmuar
Nga ndonjë shrapnel endacak

Më mirë një vdekje e plotë
Se sa një gjysmë vdekje
Sa janë të trishtuara gjërat
Kur përgjysmohen
Në gjysma të imagjinuara të fjalëve

Një gjysmë plumbi
As nuk të vret e as nuk të lë gjallë
I ngjan një gjysmë fjale të thënë
Vetëm me gjysmë goje
Asgjë e përgjysmuar nuk vlen sonte

SANA E KALBUR PREJ SHIRAVE

Asgjë nuk shoh më
Në këtë dhomë të zbrazët
Përpos qetësisë së llahtarshme
Një mushkonjë bombarduese
Me zëzëllimën e saj të trishtuar
Fshihet pas sirtarit të vjetër

Pemët në kopsht po i shkundin gjethet
Mbase kur shikoj më mirë
Asnjë shpresë nuk paska mbetur
Në degët e thyera të kujtesës
Sonte çdo gjë
Po i ngjan kësaj dhome të zbrazët

Një tërfurk i vjetër
Dhe sana e kalbur prej shirave
Qenkan ngjizur për bukuri
Dy këndesa mbi një grumbull plehu
I bëjnë zë mëngjesit
Kurse mëngjesi
Shtiret i shurdhët ndaj thirrjeve

KUAJT MË NUK HINGËLLOJNË

Jam zënë ngushtë
Si të dalë nga kjo amulli
Përballë meje trishtueshëm qëndrojnë
Flamurët e grisur
Pas shpine beteja e molisur

Kuajt më nuk hingëllojnë
Nga dizgjinët pikon beteja
Ishte një luftë e madhe
Mëgojëzave të ndryshkura
Asnjë njeri nuk ua ndali hovin
Beteja ngjante me saçin e përskuqur

Kjo luftë që s'ka fitimtarë
Paska mbetur në istikame
Përmendoret e mermerta buzëqeshin
Po ashtu qeshin edhe plumbat
Me plagët që kurrë s'do të shërohen

LUFTA IME

Nga një betejë në tjetrën
Përherë ngadhënjeva
Kur desha të luftoj me vetveten
Në atë çast
Si çdo njeri falimentova

Prishtinë, 21 shtator 2015

SHËNIME PËR ATUROTIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Për një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë u punësua si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, - kryesisht me poezi, - që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës e të penës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Ky i fundit përmbledhjen "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i madh i poezive të Ademit. Krahas krijimeve të botuara në revistat për fëmijë, u paraqit para publikut edhe me një numër shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i pranishëm në disa antologji dhe në librin "Kosova letrare" të poetes Monika Mureshan. Figuron në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, të përgatitur nga Hasan Hasani; në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i Shkrimtarëve të Durrësit ie nderoi me Çmimin e Karrierës për ndihmesën që ka dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. “Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. “Zgjimi i gjëmës”,Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. “ Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. “ Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. “ Përtej teje”,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg” , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12

48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012

64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91.”Krakëllimat e natës”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014

95,"Për kë po bie moj kambanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot, 2014
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
98. "Loti i gotës së dehur" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
99. " Stina asnjanëse" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
100. "Dëneste bashkë me erën" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
101. "Druri i pikëlluar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
102. " Një grusht dashuri" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
103. "Lëreni zërin tim" , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
104. "Shi në qytetin tim" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
105. . "Si trenat e verbër " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
106. "Zjarri i malli tim " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
107 . "Kur teshtinë era " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
108. "Mbi shpirtin e erës pagane " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
109. "Nëpër gjymtyrët e mjegullave " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014

110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”- Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
116”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ” , Poezi Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016

126. “Të dielave në qytetin tim ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës”Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
135.“ Në anën tjetër të mendjes” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet ” , Poezi,Shtëpia Botuese “TREND “Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave” , Poezi ,Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016. 138 “Nuk i them unë dot kësaj liri ” , Poezi - Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA:

Çfarë të bëj me duart e erës
Cikli i parë 17

Ky shi i ankthshëm 19
Mos ma prekni kujtesën 20
E kujt është kjo melankoli 21
Ti në daç më prit te portat e hapura 22
Çfarë të bëj me duart e erës 23
Në këto çaste të ankthshme 24
Një flutur e kaltër 25
Sa herë të shoh 26
Njëqind vjet larg kësaj dhome 27
Ky shi i çmendur që po bie sonte 28
E cila peshonte sa dhembja 29
Më thanë se kisha vdekur 31
Vetëm për mua sonte 32
Kur me dënesje qante kitara ime 33
Mbase kjo ishte një ëndërr 35
Në syrin e vashës më të bukur 36
Mbrëmë i pyeta të gjitha pemët 38
Fluturoi edhe lejleku i fundit 39
Kishin ikur edhe qivuret 40
Diku në maja gjethesh 41
Ky qytet i përgjumur 42
Vetëm si ora e vjetër 43

Një copë ëndrre mbi pasqyrë
Cikli i dytë 45

Ishte natë ose s'ishte as natë e as ditë 47
Çdo gjë ishte e kaltër atë kohë 49
Sa herë që ndryshon moti 51
Një copë ëndrre mbi pasqyrë 52
Sa pak të duhet sonte 53
Shikon kah përflaket Jugu 54
Janë radhuar edhe lypsarët 55
Mbase na zuri në befasi 56
I hapi sytë e mbyllur 57
Kjo kollitje e drurëve 58
Sivjet ndoshta nuk përsëritet gjëma 59
Ajo më nuk i përngjante njeriut 60
Ky salep Kosove 61
Mund të jem edhe një britmë 62
Nën këtë plis 63
U pëlqen heshtja 64
Nga dritaret e mbyllura 65
Ecim nëpër monopate dhembjesh 66
Nëpër sinor kanë dal legjendat 67
Ecte edhe uria 68
Mbase ishte larja e ndërgjegjes 69
Dhe sërish nga fillimi doli një tjetër fillim 70
Por për së koti ishin lutjet tona 71
Asnjë zë njeriu 72
Ishte koha e të pakohëve 73
Bërlykej edhe era 74
Merre cilëndo qoftë 75
Nata në qytetin tim 76
Brenda një fjale të vetme 77

Kësaj nuk i them dot liri
Cikli i tretë 79

Kush e di se nga kush 81
Një lloj gjaku nga i cili 83
Kësaj nuk i them dot liri 85
Por ti asnjëherë nuk e ule kokën 86
Era u binte daulleve të kushtrimit 87
S'dorëzohet dot Prekazi gjallë 88
Tytat këndojnë nëpër istikame 89
Ose gjyshi i gjyshit tim 90
Grumbuj letrash me poezi 92
Varrtarë të dalë në pension 93
Këndon edhe mëngjesi i dehur 94
Asnjë gjethe nuk paska mbetur 95
Një gjysmë plumbi 96
Sana e kalbur prej shirave 97
Kuajt më nuk hingëllojnë 98
Lufta ime 99

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Këaj nuk i them dot liri / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : "Trend", 2016. – 112 f. ; 21 cm.

Shënime për autorin : f. 100-109

ISBN 978-9951-694-46-9